



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2018 – Numri: 100

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E enjte, 5 korrik 2018

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 78/2018, datë 28.6.2018	Për zgjedhjen e një anëtari të Komisionit të Prokurimit Publik.....	6307
Vendim i Kuvendit nr. 79/2018, datë 28.6.2018	Për zgjedhjen e një anëtari të Komisionit të Prokurimit Publik.....	6307
Vendim i Kuvendit nr. 80/2018, datë 28.6.2018	Për zgjedhjen e një anëtari të Komisionit të Prokurimit Publik.....	6307
Vendim i Kuvendit nr. 81/2018, datë 28.6.2018	Për zgjedhjen e një anëtari të Komisionit të Prokurimit Publik.....	6307
Rezolutë e Kuvendit datë 28.6.2018	Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit për vitin 2017.....	6308
Rezolutë e Kuvendit datë 28.6.2018	Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionit të Prokurimit Publik (KPP) për vitin 2017.....	6309
Udhëzim i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 11/1, datë 25.6.2018	Për një ndryshim dhe disa shtesa në udhëzimin nr. 11, datë 17.4.2018, “Për rregullat e brendshme mbi mënyrën e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë”.....	6311
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 131, datë 7.6.2018	Mbi kërkesën e KESH sh.a. për rishikimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 98, datë, 30.4.2016, mbi miratimin e kontratës për shitblerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 1.1.2018–31.12.2018.....	6312

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 132, datë 7.6.2018	Mbi miratimin e draftkontratës tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike/KESH sh.a., aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe Furnizuesit e Shërbimit Universal për periudhën 1.1.2018–31.12.2018.....	6313
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 133, datë 7.6.2018	Mbi kërkesën e shoqërisë “Çaushi - Energji” sh.p.k., për modifikimin e licencës së “Prodhimit të energjisë elektrike” nr. 181, seria PV12K, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 122, datë 29.8.2012.....	6335
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 6567/4, datë 3.7.2018	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Rikonstruksion i Rrugës Transballkanike Vlorë, faza II”, për disa shtesa, korrigjime dhe ndryshime në VKM-në nr. 345, datë 4.5.2016.....	6336
	Vendim (<i>i shkurtuar</i>) për heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Agim Kopshti.....	6342

**VENDIM
Nr. 78/2018****PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI TË
KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 19/2, pika 2, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Znj. Enkeleda Bega zgjidhet anëtare e Komisionit të Prokurimit Publik.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 28.6.2018

**VENDIM
Nr. 79/2018****PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI TË
KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 19/2, pika 2, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Znj. Vilma Zhupaj zgjidhet anëtare e Komisionit të Prokurimit Publik.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 28.6.2018

**VENDIM
Nr. 80/2018****PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI TË
KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 19/2, pika 2, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Znj. Lindita Skeja zgjidhet anëtare e Komisionit të Prokurimit Publik.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 28.6.2018

**VENDIM
Nr. 81/2018****PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI TË
KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 19/2, pika 2, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Znj. Merita Zeqaj zgjidhet anëtare e Komisionit të Prokurimit Publik.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 28.6.2018



**REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË
AUTORITETIT PËR INFORMIMIN
MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT
TË SHQIPËRISË PËR VITIN 2017**

I. Kuvendi i Shqipërisë vlerëson:

Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, në vijim (AIDSSH), si institucion i pavarur, i cili jep informacion mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, në përputhje me ligjin nr. 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, dhe kuadrin ligjor që normon informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror” dhe mbrojtjen e të dhënave personale;

Strategjinë e këtij institucioni për identifikimin, mbledhjen, ruajtjen, arkivimin, përpunimin, digjitalizimin e dokumenteve arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit, si dhe informimin e subjekteve kërkuese me këto dokumente, sipas ligjit nr. 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;

Bashkëpunimin dhe bashkërendimin e veprimtarisë së Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit me autoritetet e tjera publike, si dhe institucionet homologe ndërkombëtare;

Anëtarësimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit me statusin e vëzhguesit në Rrjetin Evropian të Autoriteteve Zyrtare Përgjegjëse për Dokumentet e Policive Sekrete;

Angazhimin e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit në hartimin e akteve nënligjore, në zbatim të ligjit nr. 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, si dhe të ligjeve të tjera bazë për funksionimin e këtij institucioni.

II. Kuvendi i Shqipërisë konstaton se gjatë vitit 2017 AIDSSH-ja:

Ka propozuar miratimin e akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr. 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, për procedurën e kalimit në administrim të autoritetit të materialeve arkivore.

Ka identifikuar në një periudhë të shpejtë kohore dokumentet arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit që administroheshin nga autoritetet e tjera publike, deri në momentin e krijimit të institucionit, sipas ligjit nr. 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

Ka filluar punën për mbledhjen e dokumenteve arkivore të ish-Sigurimit të Shtetit, në zbatim të ligjit nr. 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, por procesi ende nuk ka përfunduar.

Ka administruar një numër të konsiderueshëm kërkesash nga individë, institucione kushtetuese dhe autoritete të tjera publike, për kandidatë për t’u emëruar apo ngritur në detyrë në disa institucione shtetërore, kërkesa nga subjekte politike për kandidatë për deputetë, si dhe kërkesa nga subjekte kërkuese në cilësinë e deputetëve.

Ka përgatitur strategjinë e punës dhe planin e veprimit për vitin pasardhës, duke përcaktuar përparësitë dhe objektivat që duhet të realizohen për përmbushjen e detyrave që ligji i ka ngarkuar, atë të identifikimit, mbledhjes, ruajtjes, përpunimit, informimit dhe edukimit qytetar.

Është investuar në forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar me struktura homologe të mbledhjes, ruajtjes, përpunimit, informimit mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, si dhe ka pasur mbështetjen dhe asistencën e ekspertëve të huaj të fushës.

Ka marrë pjesë në aktivitete ndërkombëtare, Konferencën Vjetore të Rrjetit Evropian të Autoriteteve Zyrtare Përgjegjëse për Dokumentet e Policive Sekrete, si rrjet i krijuar nga autoritetet e ngjashme në disa vende të Evropës (Gjermani, Poloni, Bullgari, Sllovaki, Hungari, Çeki, Rumani), bazuar dhe mbështetur edhe në iniciativën e shprehur në rezolutat nr. 1096 (1996) dhe nr. 1481 (2006) të Asamblesë së Këshillit të Evropës.

Është angazhuar në zhvillimin dhe forcimin e kapaciteteve administrative dhe të ekspertizës në fusha të ndryshme, veçanërisht ato që lidhen me informimin e individëve, institucioneve kushtetuese dhe autoriteteve publike, të medias, studiuesve dhe garantimin e transparencës në procesin e informimit.



Ka marrë statusin e vëzhguesit në Rrjetin Evropian të Autoriteteve Zyrtare Përgjegjëse për Dokumentet e Policive Sekrete.

III. Kuvendi i Shqipërisë përgjatë vitit 2018 kërkon nga AIDSSH-ja:

Përfundimin e procedurave për kalimin në administrim të Autoritetit të të gjithë dokumentacionit arkivor të ish-Sigurimit të Shtetit, nga arkivat e autoriteteve publike që i kanë në administrim aktualisht.

Përmirësimin e procedurave të ndjekura për verifikim nga Autoriteti, sipas standardeve dhe eksperiencave më të mira të institucioneve homologe në ish-kampin socialist të Evropës Lindore, me qëllim trajtimin me transparencë, objektivitet dhe profesionalizëm të kërkesave të qytetarëve.

Forcimin e kapaciteteve administrative, sigurimin e infrastrukturës së nevojshme për studiuesit me fokus të veçantë krijimin e një arkivi digjital të integruar, me qëllim aksesin sa më të gjerë për subjektet e interesuara në dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.

Rritjen e bashkëpunimit dhe të bashkërendimit të punës me institucionet dhe autoritetet publike dhe me donatorët, si dhe me organizatat homologe.

Realizimin e objektivave, në kuadër të Planit Strategjik 2017–2020, për të përmbushur detyrat që përcakton ligji nr. 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

Përmirësimin e procedurave të ndjekura për verifikimin e subjekteve, për ta bërë procesin lehtësisht të kuptueshëm për palët e interesuara dhe plotësisht të realizueshëm për vetë institucionin.

Të ndërtojë një strategji komunikimi, me qëllim informimin e qytetarëve dhe të rinjve në veçanti, nëpërmjet kumtesave në ditët kalendarike që u përkushtohen ngjarjeve tronditëse të ndodhura mbi viktima të pafajshme të diktaturës komuniste, mbi bazën e provave dhe fakteve të pakontestueshme, të bëra publike për herë të parë dhe të marra në mënyrë autentike nga dosjet e krijuara nga struktura të ish-Sigurimit të Shtetit.

Të krijojë bazën e të dhënave me emrat e subjekteve të verifikuara, informacionet për strukturat operative ose bashkëpunëtorët e ish-Sigurimit të Shtetit, që janë verifikuar dhe analizuar nga komisioni, i cili ka funksionuar në bazë të ligjit

nr. 8043, datë 30.11.1995, “Për kontrollin e figurës së zyrtarëve dhe të personave të tjerë që lidhen me mbrojtjen e shtetit demokratik” dhe atyre që janë verifikuar dhe analizuar nga AIDSSH-ja.

Të identifikojë dhe të analizojë dokumentet që mund të deklasifikohen, me qëllim bërjen publike për individët dhe studiuesit vendës dhe të huaj.

IV. Kuvendi i Shqipërisë për vitin 2018 kërkon nga Nënkomisioni Parlamentar për të Drejtat e Njeriut:

Të ndjekë nga afër veprimtarinë e AIDSSH-së, si dhe të adresojë tek institucionet përgjegjëse çështje dhe problematika që kanë të bëjnë me veprimtarinë e AIDSSH-së dhe që përfshihen brenda fushës së respektimit të të drejtave të njeriut.

Miraturar në datën 28.6.2018

KRYETARI
Gramoz Ruçi

REZOLUTË PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK (KPP) PËR VITIN 2017

Kuvendi i Shqipërisë:

Duke njohur Komisionin e Prokurimit Publik si organin më të lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj;

Duke vlerësuar si shumë të rëndësishëm për KPP-në paanësinë në vendimmarrje, transparencën, efikasitetin, si dhe mbrojtjen e interesave të ligjshëm të operatorëve ekonomikë nga veprimet apo mosveprimet e autoriteteve kontraktuese dhe, në mënyrë të veçantë, mbrojtjen e interesit publik;

Duke kërkuar dhe nxitur qeverinë në kryerjen sa më parë të procedurave ligjore dhe depozitimit në Kuvendin e Shqipërisë të propozimit të kandidaturave për anëtarë të KPP-së, për të bërë të mundur funksionimin normal dhe të plotë të institucionit;

Duke vlerësuar si shumë të rëndësishëm rolin që KPP-ja ka në rritjen e efikasitetit dhe të besueshmërisë në sistemin e prokurimit publik;

Duke vlerësuar hapat e rëndësishëm që janë ndërmarrë për rritjen e pavarësisë institucionale të KPP-së, përmes ndryshimeve të fundit ligjore;

**Për vitin 2017:**

Vlerëson bashkëpunimin me APP-në në rastet e marrjes së vendimeve për pezullimin e procedurave të prokurimit, me qëllim pasqyrimin e këtyre vendimeve në sistemin e prokurimit elektronik, për të mos lejuar autoritetet kontraktuese në vazhdimin e mëtejshëm të procedurës.

Vlerëson përpjekjet e bëra në drejtim të objektivit kryesor dhe konstant të KPP-së që është mbrojtja e interesit publik, si dhe të interesave të ligjshëm të operatorëve ekonomikë nga veprimet apo mosveprimet e autoriteteve kontraktuese në zbatimin e ligjshmërisë, në lidhje me prokurimin publik.

Vlerëson bashkëpunimin me APP-në në rastet e konstatimit të shkeljeve eventuale ligjore nga autoritetet kontraktuese dhe operatorët ekonomikë, duke i propozuar APP-së nisjen e hetimit administrativ, sipas legjislacionit për prokurimin publik.

Vlerëson bashkëpunimin e KPP-së me institucione të tjera në lidhje me përgatitjen e akteve ligjore e nënligjore që prekin procedurat e prokurimit, koncesionet/ppp, ankandet e lejet minerare.

Rekomandon:

Të marrë masa për rritjen dhe forcimin e aftësive dhe kapaciteteve profesionale si të anëtarëve të KPP-së, ashtu edhe të stafit mbështetës, puna dhe vendimmarrja e të cilëve kanë ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë dhe saktësinë e vendimeve të marra, si dhe garantimin e mbrojtjes ligjore për të gjithë pjesëmarrësit e sistemit të prokurimit publik.

Të punojë në mënyrë të vazhdueshme dhe të rrisë përpjekjet për shqyrtimin e ankesave brenda afateve ligjore, me qëllim shmangien e krijimit të situatave emergjente për autoritetet kontraktuese. Respektimi i afateve të ankesave vijon të mbetet problem serioz, me gjithë përmirësimin e bërë gjatë vitit 2017 (nga 28 % në 45,3 %).

Të mos kufizohet vetëm në shqyrtimin e ankesave me transparencë, në kohë dhe në mënyrë të pavarur e profesionale, por të luajë një rol thelbësor në kthimin e ligjshmërisë së procesit, si dhe në unifikimin e praktikave për të gjitha njësitë, të cilat përfshihen në procesin e prokurimit.

Të monitorojë me rigorozitet respektimin e detyrimit ligjor nga autoritetet kontraktuese për

vënien në dispozicion të informacionit përkatës të nevojshëm për të realizuar në mënyrë të plotë shqyrtimin administrativ dhe t'i propozojë APP-së marrjen e masave administrative, sipas ligjit, në rastet e mosrespektimit të këtij detyrimi nga ana e autoriteteve kontraktuese.

Të hartojë rekomandime të qarta mbi bazën e analizave të bëra për të gjitha institucionet, të cilat përfshihen në procesin e prokurimit publik, si dhe të bashkëpunojë me institucione të tjera të fushës për të propozuar ndryshime ligjore të nevojshme, me qëllim përmirësimin e sistemit të prokurimit publik, si dhe rritjen e efikasitetit dhe të besueshmërisë në këtë sistem.

Të rrisë profesionalizmin në shqyrtimin e ankesave të operatorëve ekonomikë, për të evituar rastet e vendimmarrjeve jo të sakta nga KPP-ja, të cilat cenojnë përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë fitues të kontratave publike dhe në jo pak raste shoqërohen edhe me dëm ekonomik.

Të marrë masa, në përputhje me ndryshimet e reja ligjore, për të depozituar sa më parë në Kuvendin e Shqipërisë propozimin për miratimin e strukturës dhe të organikës së Komisionit të Prokurimit Publik.

Të punojë për hartimin e Planit Afatmesëm Strategjik 2018–2020, në të cilin duhet të jenë përcaktuar qartë objektiva dhe indikatorë të matshëm, duke krijuar në këtë mënyrë edhe një dokument bazë të punës së KPP-së.

Të bëjë të mundur, në kuadër të projektit të digjitalizimit, krijimin e një baze të dhënash *online* në faqen *web* të institucionit për kërkimin e vendimeve të KPP-së në kohë reale, përmes filtrave dhe fjalëve kyçe, krijimi i kësaj baze të dhënash ka një impakt të drejtpërdrejtë në rritjen e transparencës dhe vendimmarrjen e qëndrueshme të KPP-së dhe njëkohësisht do të jetë një ndihmë edhe për palët e interesuara.

Të marrë masat e nevojshme që menjëherë pas konstituimit të institucionit me të gjithë anëtarët të emëruar nga Kuvendi, të miratohen rregullat e hollësishme të procedurave, si dhe rregullorja e brendshme për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të KPP-së, të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në efektivitetin dhe performancën e institucionit.

Të bashkëpunojë me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, APP-në dhe institucionet përkatëse, për të bërë të mundur përmirësimet



ligjore në afatet e shqyrtimit dhe të miratimit të ankesave për procedurat e prokurimit publik.

Të rrisë përpjekjet për informimin dhe ndërgjegjësimin e autoriteteve kontraktuese dhe operatorëve ekonomikë për rolin dhe funksionet e KPP-së, duke bërë në këtë mënyrë më eficient përdorimin e instrumentit të ankimit në KPP dhe duke ndikuar kështu edhe në rritjen e besimit të publikut në sistemin e prokurimit.

Të marrë masa që sistemi i ri digjital i administrimit të ankesave, si dhe i publikimit të të dhënave në kohë reale mbi çdo ankesë të depozituar në KPP, të ketë komponentë të tij edhe krijimin e arkivit elektronik të dosjeve për çdo ankim, me qëllim sigurimin e transparencës në procesin e administrimit të dosjeve, inspektorët që përgatisin dosjen të identifikohen në sistem dhe të mbajnë përgjegjësi për plotësinë e dokumentacionit të dosjes së ankimit.

Miratuar në datën 28.6.2018

KRYETARI
Gramoz Ruçi

UDHËZIM

Nr. 11/1, datë 25.6.2018

PËR NJË NDRYSHIM DHE DISA SHITESA NË UDHËZIMIN NR. 11, DATË 17.4.2018, “PËR RREGULLAT E BRENDSHME MBI MËNYRËN E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE GJYQËSORE TË MINISTRISË SË FINANCIVE DHE EKONOMISË”

Në mbështetje, të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës; të neneve 510, 589, të ligjit nr. 8116, datë 29.3.1996, “Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të neneve 43 e 54, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2012, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, dhe të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, ministri i Financave dhe Ekonomisë,

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 11, datë 17.4.2018, “Për rregullat e brendshme mbi mënyrën e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të Ministrisë

së Financave dhe Ekonomisë”, bëhet një ndryshim dhe disa shtesa si më poshtë:

1. Në pikën 7, kreu I, fjalët “në mënyrë periodike...”, zëvendësohen me fjalët “deri në datën 20, të çdo muaji, në lidhje me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të muajit të kaluar”.

2. Pas pikës 8, të kreut II, shtohen pikat 8.1 dhe 8.2 me këtë përmbajtje:

“8.1 Struktura përgjegjëse për ndjekjen e çështjeve gjyqësore mban *database* të veçantë për vendimet me objekt: a) kthim page; dhe b) dëmshpërblim për largim nga puna dhe *database* të veçantë për vendimet e tjera.

8.2 Përfshihet nga rregulli sipas pikës 8, për sa përcaktohet sipas “*databases*”:

a) Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë që urdhërohet nga titullari i institucionit, për rrethana lehtësuese të gjyqfituesve, të gjykuara prej tij.

b) Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë me objekt kthim page apo dëmshpërblim për largim nga puna, për gjyqfituesit, të cilët kanë mbushur moshën për daljen në pension pleqërie dhe për gjyqfituesit, të cilëve u është ekzekutuar pjesërisht vendimi i gjykatës, për sa i përket rikthimit në punë dhe ka mbetur për ekzekutim pjesa e kthimit të pagës.

c) Për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë me objekt dëmshpërblim për largim nga puna apo kthim page të ish-gjyqfituesve, të cilët kanë qenë punonjës në institucionet vartëse, ekzekutimi do të bëhet nga vetë këto institucione, pasi të jetë çelur fondi nga aparati i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

d) Kur kreditori paraqet kërkesë për shlyerjen e detyrimit deri në momentin e dorëzimit të kërkesës dhe heq dorë nga ekzekutimi i pjesës së vendimit gjyqësor të formës së prerë.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCIVE
DHE EKONOMISË
Arben Ahmetaj

**VENDIM****Nr. 131, datë 7.6.2018**

**MBI KËRKESËN E KESH SHA PËR
RISHIKIMIN E VENDIMIT TË BORDIT
TË ERE-s NR. 98, DATË, 30.4.2016, MBI
MIRATIMIN E KONTRATËS PËR
SHITBLERJEN E SASISË SË TEPËRT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE QË
REZULTON PAS PËRMBUSHJES SË
KËRKESËS SË KLIENTËVE QË
PËRFITOJNË NGA SHËRBIMI
UNIVERSAL, ME QËLLIM MBULIMIN E
HUMBJEVE NË RRJETIN E
SHPËRNDARJES PËR PERIUdhËN
KOHORE 1.1.2018–31.12.2018**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 53, 56 dhe 59, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”; nenit 16 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.6.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e drejtorive teknike mbi kërkesën e KESH sh.a., për rishikimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 98, datë 30.4.2016, “Mbi miratimin e kontratës për shitblerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 1.1.2018–31.12.2018”, të kësaj shoqërie, konstatoi se:

- ERE, me vendimin nr. 98, datë 30.4.2018, ka miratuar kontratën për shitblerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 1.1.2018–31.12.2018, ndërmjet shoqërisë KESH sh.a. dhe shoqërisë OSHEE sh.a.

- Shoqëria KESH sh.a., me shkresën e saj nr. 2680/1 prot., protokolluar në ERE me nr. 382/1 prot., datë 22.5.2018, ka përcjellë në ERE kërkesën për rishikimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 98, datë 30.4.2018, “Mbi miratimin e kontratës për shitblerjen e sasisë së tepërt të

energjisë elektrike që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 1.1.2018–31.12.2018”.

- Shoqëria KESH sh.a. e ka përcjellë me *e-mail*, fotokopje dhe jo nga adresa zyrtare e shoqërisë KESH sh.a., shkresën nr. 2680/1 prot., në datën 21.5.2018, si dhe përtej orarit zyrtar të punës në ERE.

- Neni 53 i Kodit të Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë, parashikon se afatet për kryerjen e një veprimi procedural nga palët, të quajtura në vazhdim “afatet procedurale”, përcaktohen nga ligji ose aktet nënligjore.

- Në nenin 16, pika 5, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, parashikohet se: Çdo palë e përfshirë në një procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit lidhur me atë procedurë, rishikimin e vendimit të bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabimet materiale të konstatuara.

- Në nenin 16 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, parashikohet se: Çdo palë e përfshirë në një procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit lidhur me atë procedurë, rishikimin e vendimit të bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabimet materiale të konstatuara.

- Neni 56 i Kodit të Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë, në lidhje me llogaritjen e afateve kur ato janë në ditë, parashikon: “Kur afati caktohet në ditë, në llogaritjen e tij përjashtohet dita kur ka ndodhur ngjarja, nga e cila fillon të ecë afati”.

- Në lidhje me depozitimin e kërkesës, neni 59 i Kodit të Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë parashikon se: Në përputhje me pikat 1 deri në 4, të këtij neni, kërkesa mund t’i paraqitet drejtpërdrejt organit publik brenda orarit zyrtar.

- Neni 13, i ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, parashikon se



kryetari i bordit është administratori i përgjithshëm i ERE-s. Ai është përgjegjës për administrimin e institucionit.

- Me qëllim ushtrimin e detyrave e kompetencave të tij, kryetari i ERE-s përcakton orarin zyrtar të punës. Për këtë qëllim, në zbatim të VKM-së nr. 511, datë 24.10.2002, të ndryshuar, si dhe urdhrin të kryetarit të ERE-s nr. 64, datë 29.12.2017, është vendosur se orari zyrtar i punës për punonjësit e ERE-s është nga ora 08:00 deri në orën 16:30.

- Kërkesa e shoqërisë KESH sh.a. për rishikimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 98, datë 30.4.2018, “Mbi miratimin e kontratës për shitblerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 1.1.2018–31.12.2018”, është depozituar jashtë afatit të parashikuar në nenin 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, neneve 53, 56 dhe 59, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenit 16 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016.

- Nga ana e shoqërisë KESH sh.a., nuk është parashtruar asnjë provë e re, në kërkesën e saj për rishikimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 98, datë 30.4.2018, “Mbi miratimin e kontratës për shitblerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 1.1.2018–31.12.2018”, siç parashikohet në nenin 16, pika 5, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar dhe nenit 16 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të rrëzojë kërkesën e KESH sh.a. për rishikimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 98, datë 30.4.2018, mbi miratimin e kontratës për shitblerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së

klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 1.1.2018–31.12.2018, mbështetur në pikën 5 të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe nenin 16 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, të njoftojë kërkuuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 132, datë 7.6.2018

MBI MIRATIMIN E DRAFTKONTRATËS TIP PËR SHITBLERJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE NDËRMJET SHOQËRISË SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE/KESH SHA, AKSIONET E SË CILËS KONTROLLOHEN PLOTËSISHT OSE PJESËRISHT NGA SHTETI DHE FURNIZUESIT E SHËRBIMIT UNIVERSAL PËR PERIUDHËN 1.1.2018–31.12.2018

Në mbështetje të neneve 16 dhe 20, germa “h”, të ligjit nr. 43/2015, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”; neneve 5 dhe 14, të VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, të ndryshuar, dhe nenit 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.6.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike në lidhje me miratimin e



“Kontratës për shitblerje të energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti/KESH sh.a. dhe Furnizuesit e Shërbimit Universal, për periudhën kohore 1.1.2018–31.12.2018”,

konstatoi se:

- Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, të ndryshuar me VKM-në nr. 729, datë 8.12.2017.

- Në nenin 14, të VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016, parashikohet se: këto rregulla do të shërbejnë si model i përkohshëm për funksionimin e tregut të energjisë elektrike, deri në miratimin e Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike, në përputhje me ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”. Enti Rregullator i Energjisë brenda 60 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të miratojë aktet përkatëse për zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në këto kushte.

- ERE, me shkresën nr. 186/4 prot., datë 2.3.2018, u ka kërkuar shoqërive KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a. të bëjnë me dije ERE-n mbi dispozitat në draftkontratën tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike/KESH sh.a., aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe Furnizuesit e Shërbimit Universal për periudhën 1.1.2018–31.12.2018, për të cilat nuk gjejnë dakordësinë respektivisht të dyja kompanitë dhe ka kërkuar dhënien e argumenteve ligjore përkatëse.

- Shoqëria OSHEE sh.a., në vijim të korrespondencës së sipërcituar të ERE-s, ka përcjellë në ERE shkresën nr. 3998/1 prot., datë 6.3.2018, me anë të së cilës kërkon fillimin e menjëhershëm të procedurës për të konkluduar me nënshkrimin e kësaj draftkontrate, e cila do të zgjidhte mosmarrëveshjet e krijuara mes dy shoqërive KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a.

- OSHEE sh.a. në shkresën e saj shprehet se pavarësisht korrespondencave të vazhdueshme me KESH sh.a., mbeten akoma të pazgjidhura pikat kyçe të saj që kanë të bëjnë me nomnimet dhe penaltetet dhe konkretisht neni 4 “Të drejtat dhe

detyrimet e Blerësit”, neni 5 “Të drejtat dhe detyrimet e Shitësit” dhe neni 9 “Zhdëmtimet/kompensimet.”

- KESH sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 186/7 prot., datë 7.3.2018, ka përcjellë në ERE draftkontratën tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike/KESH sh.a., aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe Furnizuesit e Shërbimit Universal për periudhën 1.1.2018–31.12.2018.

- Sipas KESH sh.a., mungesa e marrëveshjes për të krijuar një praktikë normale ndërveprimi ndërmjet shoqërive shtetërore në përmbushje të detyrimeve për shërbimin publik, siç parashikohet në legjislacionin në fuqi, është rrjedhojë e një qasjeje pozitive të munguar nga ana e shoqërisë OSHEE sh.a. për të njohur dhe pranuar parashikimet e akteve nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e licencuar në sektorin energjetik. Ajo që ka bërë të pamundur nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje sipas KESH sh.a., ka të bëjë me faktin se shoqëria OSHEE sh.a. mban qëndrimin se KESH sh.a. duhet të ndjekë profilin e ngarkesës së klientëve fundorë dhe të plotësojë sasinë sipas këtij profili.

- Në vijim të sa më sipër, ERE pasi analizoi të dy draftet e përcjella nga shoqëritë KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a., me vendimin nr. 57, datë 9.3.2018, filloi procedurën për miratimin e “Draftkontratës tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike/KESH sh.a., aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe Furnizuesit e Shërbimit Universal/OSHEE sh.a. për periudhën 1.1.2018–31.12.2018.”

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, ERE, me shkresën nr. 258 prot., datë 15.3.2018, ka kërkuar komente dhe opinione nga MIE, në lidhje me këtë fillim procedure, dhe me shkresën nr. 256 prot., datë 13.3.2018, ka kërkuar komente dhe opinione nga Autoriteti i Konkurrencës dhe OST sh.a., dhe i ka përcjellë këto shkresa për dijeni pranë KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a.

- Nga ana tjetër, kjo draftkontratë në datën 20.3.2018, i është dërguar në rrugë elektronike edhe USAID-it, për marrje mendimi.

- Në përfundim të afatit të pritjes së komenteve nga palët e interesit, nuk rezulton të ketë asnjë të tillë.



- Nisur edhe nga rëndësia e këtij akti, ERE në datën 30.3.2018, në mbështetje të neneve 27 dhe 29, të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, të miratuara me vendimin e bordit nr. 96, datë 17.6.2016, zhvilloi një seancë dëgjimore mes përfaqësuesve të ERE-s, OSHEE sh.a., KESH sh.a., OST sh.a., MIE dhe autoritetit të konkurrencës, në të cilën u diskutua mbi draftet e përcjella nga palët dhe gjetjen e dakordësisë mes tyre.

- Gjatë diskutimeve në seancë u parashtrua se mosdakordësitë midis palëve konsistojnë kryesisht në përmbajtjen e neneve 2, 4, 5, 9 dhe 14. Pas debateve të zhvilluara në këtë seancë palët arritën të dakordësojnë për programet mujore dhe javore të energjisë elektrike. Nga ana tjetër, në përfundim të seancës dëgjimore, Autoriteti i Konkurrencës u shpreh se kjo kontratë nuk bie në kundërshtim me ligjin nr. 9121, datë 28.7.20103, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar. Ndër të tjera, palëve në seance iu kërkuar të paraqesin me shkrim pranë ERE-s, dakordësitë që u arritën nga seanca dëgjimore me ndërhyrjen e MIE-s dhe mosdakordësitë, në mënyrë që ERE të vijojë me shqyrtimin dhe miratimin final të kësaj praktike.

- Në vijim të sa më sipër, në ERE, në datën 30.3.2018, kanë mbërritur komentet e USAID-it mbi këtë draftkontratë, të cilat kryesisht u morën në konsideratë dhe u reflektuan në nenet e shqyrtuara nga ERE.

- Nga ana tjetër, edhe MIE, me shkresën nr. 5106/1 prot., datë 10.4.2018, ka përcjellë në ERE mendimin e saj mbi këtë draftkontratë duke rekomanduar marrjen në konsideratë të standardeve më të mira ndërkombëtare dhe ato të aplikuara deri tani, në kuadër të marrëveshjeve të furnizimit me energji elektrike të lidhura ndërmjet KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a. duke garantuar sigurinë e furnizimit të konsumatorëve dhe kushte të drejta që balancojnë interesat e palëve si dhe mbrojtjen e interesave të klientëve fundorë gjatë përmbushjes së detyrimit të shërbimit publik nga ana e dy shoqërive.

- Në vijim të sa më sipër, ERE, pasi analizoi të dy draftet e përcjella nga shoqëritë, si dhe duke marrë në konsideratë rekomandimin e MIE-s dhe ato të USAID-it, paraqiti për shqyrtim në Bord në mbledhjen e datës 30.4.2018, këtë

praktikë. Në këtë mbledhje shoqëria OSHEE sh.a. kërkoi shtyrjen e trajtimit të kësaj praktike, për arsye se kërkoi edhe njëherë konsultimin me palët e treta të draftit të përpunuar nga ERE. Bordi i ERE-s e pranoi kërkesën e OSHEE sh.a. për trajtimin e saj pas konsultimit me palët e treta.

- Në vijim, me shkresën nr. 6972/1 prot., datë 5.6.2018, “Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë” kërkon që në çdo rast, dispozitat kontraktore të parashikojnë të drejta dhe detyrime bazuar në livrimet dhe konsumet reale të energjisë elektrike, në përputhje me parashikimet e nenit 76, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

- Për gjithë sa më sipër, ERE, pasi analizoi të dyja draftet e përcjella nga shoqëritë, si dhe duke marrë në konsideratë rekomandimin dhe kërkesën e MIE-s dhe komentet e USAID-it konkludoi si më poshtë për nenet e mosdakordësuara nga palët 2, 4, 5, 9 dhe 14;

Neni 2 “Sasia e kontraktuar”, nga ana e ERE-s u pranua versioni i KESH sh.a. për arsye se, i bën të mundur shoqërisë KESH sh.a., të ketë një planifikim për sasinë e tepërt të energjinë elektrike, në mënyrë që të ndjekë procedurat e shitblerjes së kësaj sasive energjie në tregun e hapur.

Pika 3 e shtuar në këtë nen ka përmbajtjen si më poshtë:

3. Blerësi, brenda afateve të përcaktuara nga Shitësi, është i detyruar të konfirmojë mbi mundësinë që ka për të pranuar energjinë e ofruar nga Shitësi sipas parashikimeve në pikën 2. Në rast se Blerësi, brenda afateve të përcaktuara nga Shitësi, nuk konfirmon mbi mundësinë që ka për të pranuar energjinë e ofruar nga Shitësi, sipas pikës 2, oferta quhet e refuzuar.

Neni 4 “Të drejtat dhe detyrimet e Blerësit”:

Pika 1: duke marrë në konsideratë komentet e USAID-it në lidhje me këtë përcaktim i cili vjen në zbatim të legjislacionit, si dhe rekomandimin e MIE-s, mbi adaptimin nga ERE të standardeve më të mira evropiane, ERE në referim edhe të kontratës së EFET-së, e cila përmban programin ditor, ka pranuar versionin e OSHEE sh.a., por duke hequr fjalinë e fundit nga kjo pikë. Pika 1, e nenit 4, është riformuluar si më poshtë:

1. Blerësi do t'i paraqesë Shitësit programet mujore/javore/të ditës në avancë me bazë orare/ngarkesës për klientët fundorë në përputhje me



parashikimet e akteve rregullatore në sektorin e energjisë elektrike dhe sipas formatit të parashikuar në lidhjet e kësaj kontrate.

Pika 2, ERE pranoi versionin e KESH sh.a., për arsye se vjen në frymën e “Rregullave të përkohshme të tregut shqiptar të energjisë”, sa i përket mënyrës së parashikimit të ngarkesës dhe i mundëson KESH sh.a. një planifikim dhe menaxhim sa më optimal për prodhimin e energjisë elektrike. Në përmbajtjen e kësaj pike është bërë një saktësim në mënyrën e të shprehurit të ditëve... Në përmbajtjen e kësaj pike u shtua fjala “kalendarike” pas togfjalëshit “jo më vonë se 7 ditë...”. Ky saktësim u bë në referencë të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe Kodit të Transmetimit.

Përmbajtja e kësaj pike është si më poshtë:

2. Blerësi jo më vonë se 7 ditë kalendarike përpara fillimit të muajit të livrimit do t'i dërgojë Shitësit gjithë të dhënat që lidhen me parashikimin e ngarkesës për muajin pasardhës me bazë javore/ditore të ngarkesës.

Pika 3, u pranua versioni i KESH sh.a. duke konsideruar faktin se një konceptim i tillë ekuilibron interesat e palëve për të bërë planifikimin dhe mundëson që KESH sh.a. të planifikojë operimet përkatëse për energjinë që ngelet jashtë programit javor të OSHEE sh.a. Gjithashtu, përcaktimi i ditës së mërkurë, për dërgimin e të dhënave që lidhen me parashikimin, është në referencë edhe të standardeve të ENTSO-E, për parashikimin e ngarkesës.

Përmbajtja e kësaj dispozite konsiston si më poshtë:

3. Blerësi, jo më vonë se dita e mërkurë e çdo jave, do t'i dërgojë Shitësit gjithë të dhënat që lidhen me parashikimin e ngarkesës së klientëve fundorë për javën në avancë me bazë ditore/orare të ngarkesës.

Pika 4, hiqet nga përmbajtja e nenit 4 versioni i OSHEE sh.a. me përmbajtje si më poshtë:

4. Blerësi, brenda afateve të përcaktuara nga Shitësi, është i detyruar të pranojë ose jo sasinë shtesë të ofruar nga Shitësi mbi programin e konfirmuar javor.

Kjo dispozitë u hoq nga përmbajtja e nenit 4, pasi kjo situatë ka gjetur zgjidhje në nenin 2, pika 3, të kësaj kontrate.

Pika 5, afati i përcaktuar në këtë pikë u vendos ora 11:00, duke qenë se ai i përcaktuar nga OSHEE sh.a. në orën 13:00, përkon me “gate

closure” nga ana e OST sh.a. (sipas përcaktimeve të Rregullave të Tregut) dhe nuk mundëson kohën e mjaftueshme për të dyja palët në kontratë që të konfirmojnë programet përpara mbylljes së portave.

Pika 6, me përmbajtje si më poshtë:

6. Në qoftë se shuma e programeve ditore të nominuara nga Blerësi është më e madhe se sa shuma e programeve ditore të nominuara nga Shitësi, atëherë Blerësi do të kompensohet financiarisht nga Shitësi me kostot e sigurimit të kësaj difference deri në nivelin e sasive të dakordësuara në nenin 5, pika 2”.

Kjo pikë hiqet nga përmbajtja e nenit 4, për arsye se VKM-ja nr. 244, datë 30.3.2016, e ndryshuar (neni 5, pika 3), nuk e përmban një parashikim të tillë.

Neni 5 “Të drejtat dhe detyrimet e Shitësit”

Pika 1: pranohet versioni i KESH sh.a. për të mundësuar një shfrytëzim sa më racional të energjisë së prodhuar nga KESH sh.a., dhe kryesisht për rastet e mbiprodhimit nga KESH sh.a. Për plotësimin e kësaj dispozite ERE ka shtuar një fjali në fund të saj, si dhe është pranuar shtesa e bërë nga USAID-i. Shtesat paraqitur me bold.

Pika 1, e riformuluar si më poshtë:

1. Shitësi do të livrojë dhe Blerësi do të pranojë sasinë e energjisë elektrike të konfirmuar nga Shitësi për Blerësin sipas parashikimeve në pikën 2, 3 dhe 4, ose sasinë e rëna dakord me shkrim midis Shitësit dhe Blerësit. Në rast se nuk do të ketë dakordësi midis palëve, atëherë do të jetë programi i konfirmuar nga Shitësi ai që do të zbatohet.

Pika 2, është pranuar versioni i KESH sh.a., për arsye se, kjo dispozitë vjen në frymën e “Rregullave të Përkohshme të Tregut Shqiptar të Energjisë”, sa u përket livrimit dhe konfirmimit të programeve. Në këtë dispozitë është shtuar pas fjalëve “5 ditë”, fjala “kalendarike”, në referencë të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe Kodit të Transmetimit.

2. Shitësi, jo më vonë se 5 ditë kalendarike përpara fillimit të muajit në të cilin do të bëhet livrimi, do të konfirmojë për Blerësin programet mujore/javore/ditore me bazë orare të prodhimit.

Pika 3, u pranua versioni i KESH sh.a., pasi është konceptuar në frymën e parashikimeve të “Rregullave të Përkohshme të Tregut”, për programet dhe nominimet.



3. *Shitësi në vijim të konfirmimit sipas pikës 2, jo më vonë se dita e enjte e çdo jave, do të konfirmojë për Blerësin programet javore/ditore me bazë orare të prodhimit.*

Pika 4, pranohet versioni i KESH sh.a., duke qenë se i lë më shumë kohë shoqërisë OSHEE sh.a. për një planifikim të kërkesës në shkallë më të lartë saktësie, përpara dërgimit të programeve në OST sh.a.

Pika 4, me përmbajtje si më poshtë:

4. *Shitësi, duke marrë në konsideratë konfirmimet e dërguara për muajin/javën në avancë do t'i dërgojë Blerësit brenda orës 12:00 konfirmimin për programin e ditës në avancë me bazë orare të prodhimit dhe do të jetë përgjegjës për realizimin e programit për ditën në avancë.*

Pika 5, hequr nga përmbajtja e nenit duke marrë në konsideratë edhe propozimin e USAID-it. Gjykohet se ky është një detyrim i paarsyeshëm vendosur për kompaninë KESH sh.a. KESH sh.a. duhet të jetë përgjegjës vetëm për ofrimin e energjisë elektrike, e cila vjen nga detyrimi i shërbimit universal me çmim të rregulluar. Çdo energji elektrike e tepërt mbi këtë detyrim duhet të jetë akoma për t'u livruar, por sipas çmimeve të tregut, jo me çmime të rregulluara.

Në fakt, vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 244/2016, “Mbi detyrimin e shërbimit publik”, përmend që çdo energji shtesë që ka KESH pas përmbushjes së kërkesës së Shërbimit Universal të Furnizimit mund t'i ofrohet OSHEE sh.a. për mbulimin e humbjeve të shpërndarjes. Çmimi për këtë energji llogaritet në bazë të çmimeve HUPEX. Duke qenë që OSHEE sh.a. dhe KESH sh.a. do të kenë kontrata të veçanta për blerjen e energjisë për humbjet, kjo dispozitë nuk është objekt i parashikimeve të kësaj kontrate.

Pika 6, pranohet paragrafi i OSHEE sh.a. me përmbajtje si më poshtë, por me orarin të ndryshuar nga 13:00 në 12:00, duke qenë se ora 13:00 përkon me “gate closure” nga ana e OST-së sikurse e kemi shpjeguar edhe më sipër.

6. *Shitësi, duke marrë në konsideratë konfirmimet e dërguara për muajin/javën në avancë do t'i dërgojë blerësit brenda orës 12:00 konfirmimin për programin e ditës në avancë me bazë orare të prodhimit dhe do të jetë përgjegjës për realizimin e programit për ditën në avancë.*

Pika 7, hiqet nga përmbajtja e nenit si më poshtë, për arsye se VKM nr. 244, datë 30.3.2016, i ndryshuar (neni 5, pika 3), nuk e përmban një parashikim të tillë.

7. *N.q.s. shuma e programeve ditore të nominuara nga Blerësi është më e madhe se sa shuma e programeve ditore të nominuara nga Shitësi, atëherë Blerësi do të kompensohet financiarisht nga Shitësi me kostot e sigurimit të kësaj difference deri në nivelin e sasive të dakordësuara në nenin 5, pika 2.*

Sa më sipër përmbajtja e nenit 5 merr dhe numërtim të ri të pikave në përmbajtjen e tij si rezultat i ndërhyrjeve.

Neni 9, Zhdëmtimet/kompensimet

Sa i përket këtij neni, ERE ka pranuar propozimin e KESH sh.a. për arsye se VKM-ja nr. 244, datë 30.3.2016, e ndryshuar, në nenin 5, pika 3 të tij trajton kompensimet, sikurse i ka pasqyruar edhe KESH sh.a. në versionin e tij të nenit 9. Në fund të pikës 1, të nenit 9, ERE ka ndërhyrë duke përmirësuar përmbajtjen e dispozitës, me shtesën e reflektuar më poshtë me bold.

Neni 9, sipas KESH sh.a. pranuar nga ERE si më poshtë:

1. RASTI I MOSPERFORMANCËS NGA ANA E SHITËSIT: Në atë shkallë që Shitësi (“Pala Livruese”) nuk i konfirmon Blerësit të gjithë sasinë mujore/javore/ditore të përcaktuar në pikën 1, të nenit 2, të kontratës, por në çdo rast jo më shumë se sasia e nevojshme për furnizimin e klientëve fundorë që përfitojnë nga shërbimi universal i furnizimit dhe kjo paafësi nuk shfaqësohet nga një ngjarje e forcës madhore ose nga mosperformanca e Palës tjetër, Blerësi (“Pala Pranuese”) ka të drejtën e një kompensimi për sasinë e energjisë elektrike që rezulton si diferencë ndërmjet sasisë së përcaktuar në pikën 1, të nenit 2 dhe asaj të konfirmuar/nominuar sipas parashikimeve të nenit 4. Në rast se kjo sasi nuk do të plotësohet, atëherë do të kompensohet sipas nenit 5, të VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016, i ndryshuar.

2. RASTI I MOSRESPEKTIMIT NGA ANA E BLERËSIT: Në atë shkallë që programet e dërguara nga Blerësi dhe të konfirmuara nga Shitësi në lidhje me sasinë e energjisë elektrike për muajin përkatës, në përputhje me parashikimet e nenit 4 dhe 5, rezultojnë më të ulëta se sasia e parashikuar në pikën 1, të nenit 2, atëherë Shitësi për efekt të llogaritjes së sasisë vjetore të energjisë elektrike në kuadër të detyrimit për shërbim publik, konsiderohet se ka përmbushur detyrimin për periudhën në fjalë në sasinë e përcaktuar në pikën 1 të nenit 2 të kësaj kontrate.



3. Në atë shkallë që programet e dërguara nga Blerësi dhe të konfirmuara nga Shitësi në lidhje me sasinë e energjisë elektrike për muajin përkatës, në përputhje me parashikimet e neneve 4 dhe 5, rezultojnë më të larta se sasia e parashikuar në pikën 1, të nenit 2, dhe kjo energji ka shkuar për furnizimin klientëve fundorë ose mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes, atëherë Shitësi konsiderohet se ka përmbushur, në po atë masë shtese, detyrimin për muajin pasardhës që i korrespondon sasisë së parashikuar në pikën 1, të nenit 2, për sasinë që ka shkuar për furnizimin e klientëve fundorë, si dhe për rastin kur energjia ka shkuar për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike do t'i faturojë Blerësit sasinë e energjinë elektrike sipas çmimit të përcaktuar në VKM-në nr. 244/2016, të ndryshuar.

4. Shuma e pagueshme: shumat e pagueshme sipas nenit 9 do të faturohen dhe paguhen sipas nenit 14 (Faturimi dhe pagesa).

Neni 14 “Faturimi dhe pagesa”, është konceptuar në referencë të kontratave të tjera të miratuara nga ERE (të tillë si marrëveshja e transmetimit dhe shpërndarjes, kontratën tip për shitblerje të energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a. dhe Prodhuesve me Përparësi të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin nr. 101, datë 23.6.2016 të bordit të ERE-s, i ndryshuar, me vendimin nr. 147, datë 30.9.2016 të bordit të ERE-s), gjithashtu, ky formulim reflekton edhe kërkesën e MIE shprehur me shkresën nr. 6972/1 prot., datë 5.6.2018, si në vijim: “Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë kërkon që në çdo rast, dispozitat kontraktore të parashikojnë të drejta dhe detyrime bazuar në livrimet dhe konsumet reale të energjisë elektrike, në përputhje me parashikimet e nenit 76, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”. Në këtë kuptim është shtuar edhe paragrafi 6, në nenin 14, si më poshtë:

Përmbajtja e nenit të riformuluar si më poshtë:

Neni 14

Faturimi dhe pagesa

1. Blerësi brenda datës 5 të muajit pasardhës të livrimit të energjisë elektrike, duhet t'i dërgojë shitësit informacion mbi sasinë faktike të energjisë elektrike shitur klientëve fundorë që përfitojnë nga furnizimi i shërbimit universal, me qëllim sistemimin e veprimeve sipas nenit 9 të kësaj kontrate.

Faqe|6318

2. Shitësi do t'i dorëzojë Blerësit një faturë sipas formatit dhe standardeve që parashikon legjislacioni në fuqi, e cila paraqet sasi të totale të energjisë elektrike të livruar nga Shitësi dhe konsumuar nga Blerësi për muajin kalendarik paraardhës. Paraqitja e kësaj fature do të bëhet brenda datës 10 të muajit pasardhës të livrimit të energjisë elektrike (ose kur kjo datë është pushim zyrtar, ditën pasardhëse të punës). Krahas faturës, Shitësi do t'i dorëzojë Blerësit edhe aktrakordin përkatës. Nëse Blerësi nuk dorëzon brenda afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, informacion mbi sasinë faktike të energjisë elektrike shitur klientëve fundorë, atëherë Shitësi do të lëshojë faturën çdo datë 10 të muajit respektiv, bazuar në sasi të totale të programuara/konfirmuara.

3. Pagesa; Blerësi do t'i kryejë pagesën Shitësit kundrejt vlerës së faturës mujore. Pagesa do të bëhet brenda 30 ditëve nga dita e njoftimit të faturës nga Shitësi. Data e pagesës do të konsiderohet data që nga llogaria e Blerësit preken fondet monetare.

4. Vonesa në kryerjen e pagesës; nëse Blerësi dështon në kryerjen e pagesës brenda afatit të përcaktuar në këtë kontratë, shpërblimi për dëmet e shkaktuara si rezultat i vonesës do të jetë sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

5. Shumat e diskutueshme; për çdo pretendim që lidhet me saktësinë e faturës do të jepet një shpjegim me shkrim nga Shitësi ose Blerësi dhe korrektimet në faturë do të bëhen vetëm brenda muajit të faturoar, në të kundërt do të paguhet shuma e faturoar jo më vonë se data e afatit të pagesës dhe diferencat (shtesat apo pakësimet) nga korrektimet do të reflektohen në muajt pasardhës.

6. Kur dhe nëse të dhënat janë të disponueshme, e konfirmojnë se sasia e energjisë së livruar dhe të marrë, ndryshon nga sasia e energjisë së programuar për livrim, faturimet do të axhustohen brenda muajit respektiv për të reflektuar ndryshimet e devijimet midis programit dhe sasisë aktuale të livruar.

- Ndërsa u parashtruan më sipër vlen të përmendim edhe faktin se ERE ka ndërhyrë në saktësimin e “bazës ligjore”, të përmendur në këtë kontratë nga palët.

- Në kuptim të VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për



miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, të ndryshuar, e cila përcakton ndër të tjera se kontrata e furnizuesit të Shërbimit Universal, të cilit i është vendosur detyrimi i shërbimit publik për të blerë sasinë e nevojshme të energjisë elektrike, të prodhuar nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti, duhet të funksionojë si një marrëdhënie e rregulluar ku sasia dhe çmimi i energjisë elektrike, për qëllime të furnizimit të Furnizuesit të Shërbimit Universal, miratohet nga Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë së prodhimit të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë kontratën tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike/KESH sh.a., aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal, për periudhën 1.1.2018–31.12.2018 (bashkëlidhur).

2. Për periudhën 1.1.2018–31.5.2018, nëse sasia e energjisë së livruar dhe të marrë, ndryshon nga sasia e energjisë së programuar për livrim, faturimet do të axhustohen nga palët në këtë kontratë për të reflektuar ndryshimet e devijimet midis programit dhe sasisë aktuale të livruar brenda muajit qershor 2018.

3. Palët deri në nënshkrimin e një kontrate midis tyre, për furnizimin me energji elektrike për periudhat pasardhëse, për marrëdhënien e furnizimit me energji elektrike për qëllime të furnizimit të shërbimit universal, do të zbatojnë kontratën e miratuar nga ERE me këtë vendim.

4. Në çdo rast, sasia dhe çmimi i shitjes së energjisë elektrike për qëllime të furnizimit të Furnizuesit të Shërbimit Universal, nga shoqëria e prodhimit e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, është sipas VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të

licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, të ndryshuar.

5. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë OSHEE sh.a., KESH sh.a., dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

kesh
KORPORATA
ELEKTROENERGJITIKE
SHQIPTARE
Energji e pastër që nuk shpërthen!
Nr. __ prot, datë __. __. 2018

OSHEE
OPERATORI I SHPËRNDARJES
SË ENERGJISË ELEKTRIKE
Nr. __ prot, datë __. __. 2018

KONTRATË PËR SHITBLERJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE NDËRMJET SHOQËRISË SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE/KESH SHA, AKSIONET E SË CILËS KONTROLLOHEN PLOTËSISHT OSE PJESËRISHT NGA SHTETI DHE FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL PËR FURNIZIMIN E KLIENTËVE FUNDORË PËR PERIUDHËN KOHORE 1.1.2018–31.12.2018

E lidhur sot, në datën __. __. 2018, ndërmjet:

Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare, KESH sh.a., regjistruar si person juridik me vendimin nr. 12728, datë 6.11.1995 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me seli në rrugën “Eshref Frashëri”, kompleksi “Vizion”, nr. 8 Tiranë, Shqipëri, me nr. NIPT-i J61817005F, e përfaqësuar nga z. Agron Hetoja, administrator i shoqërisë KESH sh.a., që më poshtë do të quhet “Shitësi”,

dhe

Furnizuesi i Shërbimit Universal, me ofertë private, me objekt aktiviteti në: furnizimin me energji elektrike të klientëve fundorë që veprojnë në treg të rregulluar të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi, ofrimin dhe sigurimin e



cilësisë tregtare të shërbimit, si dhe çdo aktivitet tjetër fitimprurës me interes për shoqërinë, regjistruar si person juridik me regjistrimin në datën 28.3.2018, me seli në bulevardin “Gjergj Fishta”, ndërtesa nr. 88 H.I, Njësia Administrative nr. 7,1023 Tiranë, Shqipëri, me nr. NIPT-i (L81 530016L), përfaqësuar nga administratori i shoqërisë që më poshtë quhet “Blerësi”,

“Palët” ose “Pala” në këtë kontratë do të referohen në cilësinë e Shitësit, prodhuesit aksionet e së cilit kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti (KESH sh.a.) dhe në cilësinë e Blerësit, Furnizuesit të ngarkuar me detyrimin e Shërbimit Universal të Furnizimit.

Baza ligjore: Neni 20, germa “h”, e ligjit nr. 43/2015, datë 30.4.2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; vendimi nr. 244, datë 30.3.2016, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike” i ndryshuar, neni 5, pika 2; “Kodi i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, kapitulli II; vendimi i Bordit të ERE-s nr. 183, datë 10.11.2017, “Mbi miratimin e Kodit të Transmetimit”, vendimi i bordit të ERE-s nr. 139/2016 “Mbi miratimin e Rregullave të Përkohshme të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, kapitulli II, pika 2.7; vendimi i bordit të ERE-s nr. 112, datë 8.7.2016, “Për përcaktimin e të licencuarit të ngarkuar me detyrimin e shërbimit universal për tregun e energjisë elektrike dhe përcaktimin e kushteve për ushtrimin e detyrimit të shërbimit universal”, vendimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s, vendimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 97, datë 27.10.2014, “Për licencimin e shoqërisë Operatori i Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. në aktivitetin e Furnizuesit Publik me Pakicë”, vendimi i bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.6.2016, “Mbi miratimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike” dhe vendimi i bordit të ERE-s nr. 98, datë 17.6.2016 “Mbi miratimin e licencës për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”, vendim i bordit të ERE-s nr. 193, datë 24.11.2017 “Mbi miratimin e Rregullave të

përkohshme për mekanizmin balancues të energjisë elektrike”; vendimi i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë (në cilësinë e përfaqësuesit të shtetit si pronar i aksioneve të KESH sh.a. në Asamblenë e Përgjithshme të shoqërisë) nr. 3924/1, datë 26.12.2017, “Mbi miratimin e programit financiar të shoqërisë KESH sh.a. për vitin 2018”.

Në kushtet kur:

- Furnizuesi i Shërbimit Universal, në aktivitetin e licencuar të furnizuesit, është ngarkuar me detyrimin e Shërbimit Universal të Furnizimit me energji elektrike për kategorinë e klientëve fundorë që përfitojnë nga Shërbimi Universal i Furnizimit me energji elektrike, në përputhje me parashikimet e pikës 1, të nenit 109, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, dhe vendimit nr. 449, datë 15.6.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kushteve dhe procedurave për përcaktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit të energjisë elektrike;

- Furnizuesit e Shërbimit Universal i është vendosur detyrimi i shërbimit publik për të blerë sasinë e nevojshme të energjisë elektrike, të prodhuar nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti;

- Sasia e energjisë elektrike, për qëllime të furnizimit të Furnizuesit të Shërbimit Universal, miratohet nga Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë së prodhimit të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, duke u bazuar në nivelin historik mesatar vjetor të dhjetë viteve të fundit, sipas informacionit të dhënë nga ERE dhe regjimit racional të shfrytëzimit të kapaciteteve gjeneruese.

- KESH sh.a. është shoqëria e prodhimit aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti;

- Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë (në cilësinë e përfaqësuesit të shtetit si pronar i aksioneve të KESH sh.a. në Asamblenë e Përgjithshme të shoqërisë), me vendimin nr. 3924/1, datë 26.12.2017, “Mbi miratimin e programit financiar të shoqërisë KESH sh.a. për vitin 2018” ka miratuar sasinë dhe çmimin e shitjes së energjisë elektrike për qëllime të furnizimit të Furnizuesit të Shërbimit Universal në kuadër të detyrimit për shërbim publik.



- Sasia e energjisë elektrike dhe çmimi i miratuar pasqyrohen në kontratën e miratuar nga ERE, sipas përcaktimeve të shkronjës “h”, të nenit 20, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

Palët bien dakord lidhur me përmbajtjen e kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike në kuadër të përmbushjes së detyrimit për shërbim publik si më poshtë vijon:

Neni 1

Qëllimi i kontratës

Kjo kontratë (së bashku me shtojcat e saj) rregullon të gjithë marrëdhënien e shitjes dhe të blerjes së energjisë elektrike ndërmjet Palëve, përfshirë këtu dhe jo vetëm programimin, nominimin, livrimin dhe pranimin e energjisë elektrike për periudhën kohore 1.1.2018–31.12.2018.

Neni 2

Sasia e kontraktuar

1. Sasia e programuar/e kontraktuar e prodhimit të energjisë elektrike që Shitësi do t'i livrojë Blerësit, përcaktohet sipas vendimit të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 3924/1, datë 26.12.2017, “Mbi miratimin e programit financiar të shoqërisë KESH sh.a. për vitin 2018” dhe sipas këtij vendimi është 3,950,000 mwh, e cila specifikohet sipas muajve të livrimit sipas tabelës së aneksit 1 bashkëlidhur kësaj kontrate.

2. Shitësi, në varësi të përmirësimit të kushteve hidrike, të gjithë sasinë e prodhimit të energjisë elektrike mbi atë të parashikuar në pikën 1, por në çdo rast, jo më shumë se sasia e nevojshme për furnizimin e klientëve fundorë që përfitojnë nga shërbimi universal i furnizimit, është i detyruar t'ia ofrojë Blerësit me çmimin e përcaktuar në këtë kontratë.

3. Blerësi, brenda afateve të përcaktuara nga Shitësi, është i detyruar të konfirmojë mbi mundësinë që ka për të pranuar energjinë e ofruar nga Shitësi, sipas parashikimeve në pikën 2. Në rast se Blerësi, brenda afateve të përcaktuara nga Shitësi, nuk konfirmon mbi mundësinë që ka për të pranuar energjinë e ofruar nga Shitësi sipas pikës 2, oferta quhet e refuzuar.

Neni 3

Përkufizimet dhe ndërtimi

1. Përkufizimet: termat e përdorur në kontratë do të kenë kuptimet e dhëna në shtojcën 1.

2. Interpretimi: titujt dhe nëntitujt janë vetëm për lehtësi dhe nuk prekin interpretimin e Kontratës.

3. Referencat në kohë: referencat në kohë do të jenë sipas Kohës Qendrore Evropiane (CET).

4. Përputhja me aktet nënligjore dhe Rregullat e Tregut: kjo kontratë hartohet në përputhje me parashikimet e akteve ligjore dhe nënligjore në sektorin e energjisë elektrike. Në rast se ndonjë parashikim në këtë kontratë bie në kundërshtim me ndonjë parashikim në aktet ligjore dhe rregullatore në fuqi, atëherë ky parashikim në kontratë konsiderohet i pavlefshëm/ i pazbatueshëm dhe marrëdhënia rregullohet sipas parashikimeve të aktit në fuqi.

Neni 4

Të drejtat dhe detyrimet e Blerësit

1. Blerësi do t'i paraqesë Shitësit programet mujore/javore/të ditës në avancë me bazë orare/të ngarkesës për klientët fundorë, në përputhje me parashikimet e akteve rregullatore në sektorin e energjisë elektrike dhe sipas formatit të parashikuar në lidhjet e kësaj kontrate.

2. Blerësi, jo më vonë se 7 ditë kalendarike përpara fillimit të muajit të livrimit, do t'i dërgojë Shitësit gjithë të dhënat që lidhen me parashikimin e ngarkesës për muajin pasardhës me bazë javore/ditore të ngarkesës.

3. Blerësi, jo më vonë se dita e mërkurë e çdo jave do t'i dërgojë Shitësit të dhënat që lidhen me ngarkesën e klientëve fundorë, për sasinë e javës në avancë me bazë ditore/orare.

4. Blerësi, duke marrë në konsideratë programet e dërguara për muajin/javën në avancë nga Shitësi, do t'i dërgojë Shitësit, brenda orës 11:00, programin e ditës në avancë me bazë orare të ngarkesës.

Neni 5

Të drejtat dhe detyrimet e Shitësit

1. Shitësi do të livrojë dhe Blerësi do të pranojë sasinë e energjisë elektrike të konfirmuar nga Shitësi për Blerësin, sipas parashikimeve në



pikat 2, 3 dhe 4, ose sasitë e rëna dakord me shkrim midis Shitësit dhe Blerësit. Në rast se nuk do të ketë dakordësi midis Palëve, atëherë do të jetë programi i konfirmuar nga Shitësi ai që do të zbatohet.

2. Shitësi, jo më vonë se 5 ditë kalendarike përpara fillimit të muajit në të cilin do të bëhet livrimi, do të konfirmojë për Blerësin programet mujore/javore/ditore me bazë orare të prodhimit.

3. Shitësi, në vijim të konfirmimit sipas pikës 2, jo më vonë se dita e enjte e çdo jave, do të konfirmojë për Blerësin programet javore/ditore me bazë orare të prodhimit.

4. Shitësi, duke marrë në konsideratë konfirmimet e dërguara për muajin/javën në avancë do t'i dërgojë Blerësit brenda orës 12:00 konfirmimin për programin e ditës në avancë me bazë orare të prodhimit dhe do të jetë përgjegjës për realizimin e programit për ditën në avancë.

Neni 6

Detyrimet kryesore për furnizimin me energji elektrike

1. Përgjegjësia për balancimin e energjisë: Shitësi dhe Blerësi janë subjekte të rregullave të në fuqi për mekanizimin e balancimit dhe për rrjedhojë përgjegjës për balancimin e energjisë elektrike.

2. Livrimi dhe pranimi: Shitësi do të programojë, shesë dhe livrojë, ose do të bëjë të mundur të livrohet, dhe Blerësi do të programojë, blejë dhe pranojë, ose do të bëjë të mundur të pranohet sasia e kontratës sipas programit të deklaruar për ditën në avancë; dhe Blerësi do t'i paguajë Shitësit çmimin përkatës të kontratës.

3. Përkufizimi i programit: "Program" sipas zbatimit, do të thotë veprimet e nevojshme për një Palë për kryerjen e detyrimeve përkatëse të livrimit ose pranimit, që mund të përfshijnë nominimin, programimin, njoftimin, kërkimin dhe konfirmimin me Palën tjetër, agjentët dhe përfaqësuesit e tyre të autorizuar përkatës, dhe me OST-në, kur aplikohet, sasinë e kontratës, kapacitetin e kontratës, Pikën e Livrimit, programin e livrimit, periudhën totale të furnizimit, dhe çdo kusht tjetër përkatës të kontratës sipas gjithë rregullave të zbatueshme të OST-së dhe praktikave e procedurave të tjera të zakonshme industriale.

Neni 7

Livrimi, matja, transmetimi dhe risku

1. Rryma/frekuenca/tensionet: energjia elektrike do të livrohet me rrymën, frekuencën dhe tensionin e zbatueshëm në Pikën përkatëse të Livrimit sipas standardeve të OST-së dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal, kur aplikohet, si dhe në përputhje me rregullat dhe kodet në fuqi.

2. Programet e deklaruara: sasia e energjisë elektrike që do të programohet dhe konfirmohet nga Shitësi për Blerësin, do t'i livrohet këtij të fundit mbi baza vjetore, mujore, javore, ditore dhe orare në përputhje me Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike, si dhe Kodet e Rrjetit. Nominimi fizik/programi për ditën e nesërme duhet paraqitur në oraret në përputhje me Rregullat të Tregut dhe kodet në fuqi.

3. Dokumentacioni i livrimeve dhe marrjeve në dorëzim: bazuar në një kërkesë të arsyeshme, Palët:

- do t'i sigurojnë njëra-tjetrës dokumentacionin që posedojnë ose do të kontrollojë paraqitjen e programeve, sasive, livrimeve dhe marrjeve në dorëzim të energjisë elektrike për qëllimet e përcaktimit të shkakut të çdo devijimi mes afateve të kontratës individuale dhe marrjeve aktuale në dorëzim të energjisë elektrike;

4. Rimbursimi i kostove të jashtme: në rast se njëra Palë, me kërkesën e Palës tjetër ose për të zgjidhur një mosmarrëveshje të ngritur nga Pala tjetër, pëson shpenzime të jashtme të arsyeshme, kur verifikon se Pala tjetër nuk i ka kryer si duhet detyrimet e saj sipas kushteve të kontratës, këto shpenzime do të rimbursohen me kërkesën e Palës që ka dështuar në performim.

5. Risqet e Shitësit dhe Blerësit: Shitësi do të marrë përsipër gjithë risqet dhe do të përgjigjet për çdo kosto apo pagesë të vendosur ose shoqëruese të Programimit, transmetimit dhe livrimit të sasisë së kontratës deri në Pikën e Livrimit. Blerësi do të marrë përsipër gjithë risqet dhe do të përgjigjet për çdo kosto ose pagesë të vendosur ose shoqëruese të Programimit, pranimit dhe transmetimit të sasisë së kontratës në dhe nga Pika e Livrimit.

6. Pikat e Livrimit: Shitësi do ta livrojë energjinë elektrike në hyrje të sistemit të transmetimit të OST-së, me kusht që të



ekzistojnë matës në këto pika për të lejuar verifikimin e shumave dhe kohës së livrimeve.

Neni 8

Mosperformanca për shkak të forcës madhore

1. Përkufizimi i forcës madhore: përveçse kur specifikohet ndryshe, “forcë madhore” për qëllimet e kontratës do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të arsyeshëm të Palës që pretendon forcën madhore (“Pala Pretenduese”), siç përcaktohet në ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, që nuk mund ta shmangte ose ta kapërcente në mënyrë të arsyeshme dhe që bën të pamundur që Pala Pretenduese të kryejë detyrimet e livrimit ose pranimin, për shkak të mëposhtme, por pa u kufizuar me to:

a) Defekti në komunikim ose i sistemeve kompjuterike të OST-së përkatëse që e pengon Palën Pretenduese të kryejë detyrimet e livrimit ose pranimin; ose

b) Pezullimi nga OST-ja përkatëse të livrimit, pranimin ose injorimit prej saj të detyrimeve të Palës Pretenduese lidhur me programimin sipas kontratës.

2. Çlirimi nga detyrimet e livrimit dhe pranimin: nëse një Palë pengohet plotësisht ose pjesërisht për shkak të forcës madhore, në kryerjen e detyrimeve të saj për livrim dhe pranim sipas një ose më shumë kontratave dhe kjo Palë respekton kërkesat e pikës 8.3 (*Njoftimi dhe lehtësimi i forcës madhore*), do të konsiderohet se nuk ka ndodhur asnjë shkelje ose mospagim nga ana e Palës Pretenduese dhe ajo do të çlirohet (dhe jo thjesht pezullohet) nga këto detyrime për atë periudhë kohore dhe në atë shkallë që kjo forcë madhore e pengon performancën e saj. Asnjë detyrim për të paguar dëmet sipas pikës 8 (*Zhdëmtimet për paaftësinë për livrim dhe pranim*) nuk do t’i merret Palës Pretenduese lidhur me sasinë e palivruara ose të pamarra.

3. Njoftimi dhe lehtësimi i forcës madhore: Pala Pretenduese, sa më shpejt që të jetë e mundur pasi mëson për forcën madhore, do të njoftojë Palën tjetër për fillimin e forcës madhore dhe, për aq sa është e mundur, do t’i sigurojë një vlerësim jodetyrues mbi zgjatjen dhe kohëzgjatjen e pritshme të paaftësisë së saj performuese. Pala Pretenduese do të përdorë gjithë përpjekjet komercialisht të arsyeshme për

të lehtësuar efektet e forcës madhore dhe gjatë vazhdimin të forcës madhore, do t’i sigurojë Palës tjetër përditësime të arsyeshme, kur dhe nëse disponohen, mbi zgjatjen dhe kohëzgjatjen e pritshme të paaftësisë performuese.

4. Efektet e forcës madhore mbi palën tjetër: në rast dhe në atë shkallë që Shitësi çlirohet nga detyrimet e livrimit për shkak të forcës madhore, Blerësi do të çlirohet, gjithashtu, nga detyrimet korresponduese të pranimin dhe pagesës. Në rast dhe në atë shkallë që Blerësi çlirohet nga detyrimet e pranimin për shkak të forcës madhore, Shitësi do të çlirohet, gjithashtu, nga detyrimet korresponduese të livrimit.

Neni 9

Zhdëmtimet/kompensimet

1. RASTI I MOSPERFORMANCËS NGA ANA E SHITËSIT: Në atë shkallë që Shitësi (“Pala Livruese”) nuk i konfirmon Blerësit të gjithë sasinë mujore/javore/ditore të përcaktuar në pikën 1, të nenit 2, të kontratës, por në çdo rast jo më shumë se sasia e nevojshme për furnizimin e klientëve fundorë që përfitojnë nga Shërbimi Universal i Furnizimit dhe kjo paaftësi nuk shfaqësohet nga një ngjarje e forcës madhore ose nga mosperformanca e Palës tjetër, Blerësi (“Pala Pranuese”) ka të drejtën e një kompensimi për sasinë e energjisë elektrike që rezulton si diferencë ndërmjet sasisë së përcaktuar në pikën 1, të nenit 2 dhe asaj të konfirmuar/nominuar sipas parashikimeve të nenit 4. Në rast se kjo sasi nuk do të plotësohet, atëherë do të kompensohet sipas nenit 5, të VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016, i ndryshuar.

2. RASTI I MOSRESPEKTIMIT NGA ANA E BLERËSIT: Në atë shkallë që programet e dërguara nga Blerësi dhe të konfirmuara nga Shitësi në lidhje me sasinë e energjisë elektrike për muajin përkatës, në përputhje me parashikimet e neneve 4 dhe 5, rezultojnë më të ulëta se sasia e parashikuar në pikën 1, të nenit 2, atëherë Shitësi për efekt të llogaritjes së sasisë vjetore të energjisë elektrike në kuadër të detyrimit për shërbim publik, konsiderohet se ka përmbushur detyrimin për periudhën në fjalë në sasinë e përcaktuar në pikën 1, të nenit 2, të kësaj kontrate.

3. Në atë shkallë që programet e dërguara nga Blerësi dhe të konfirmuara nga Shitësi në lidhje



me sasinë e energjisë elektrike për muajin përkatës, në përputhje me parashikimet e neneve 4 dhe 5, rezultojnë më të larta se sasia e parashikuar në pikën 1, të nenit 2, dhe kjo energji u ka shkuar për furnizimin klientëve fundorë ose mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes, atëherë Shitësi konsiderohet se ka përmbushur, në po atë masë shtesë, detyrimin për muajin pasardhës që i korrespondon sasisë së parashikuar në pikën 1, të nenit 2, për sasinë që ka shkuar për furnizimin e klientëve fundorë, si dhe për rastin kur energjia ka shkuar për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike do t'i faturojë Blerësit sasinë e energjinë elektrike sipas çmimit të përcaktuar në VKM-në nr. 244, datë 30.3.2016, i ndryshuar.

4. Shuma e pagueshme: shumat e pagueshme sipas nenit 9 do të faturohen dhe paguhen sipas nenit 14 (Faturimi dhe pagesa).

Neni 10

Pezullimi i livrimit

1. Përveç të drejtave ose zhdëmtimeve të tjera të disponueshme për një Palë ("Pala që përmbush detyrimet"), nëse njëra Palë ("Pala që nuk përmbush detyrimet") nuk paguan ndonjë pagesë të vendosur sipas kontratës, ose nëse ajo ose garanti i kredisë nuk arrin ta sigurojë, zëvendësojë ose rrisë shumën e sigurisë së performancës të kërkuar sipas kontratës ose çdo dokumenti mbështetës të kredisë, Pala që përmbush detyrimet do të autorizohet, jo më parë se 3 (tri) ditë pune pas dërgimit të një njoftimi me shkrim Palës që nuk përmbush detyrimet, që të pushojë menjëherë livrimet e mëtejshme të energjisë elektrike (dhe të çlirohet (dhe jo thjesht të pezullohet) nga detyrimet kryesore të livrimit) sipas gjithë kontratave individuale deri kur Pala që përmbush detyrimet të ketë marrë kolateralin e kërkuar ose pagesën e plotë (përfshirë gjithë interesat e mospagimit dhe shpenzimet e zbatueshme) të gjitha shumave të papaguara që i detyrohen palës që përmbush detyrimet. Pezullimi i livrimeve apo çlirimeve të detyrimeve të tjera të livrimit, nga Palët mund të bëhet vetëm me miratimin e ERE-s.

Neni 11

Kohëzgjatja dhe të drejtat e përfundimit

1. Kjo kontratë do të hyjë në fuqi në datën e miratimit nga ERE dhe i shtrin efektet nga data 1.1.2018 deri më 31.12.2018. Ajo mund të përfundohet apo ndryshohet vetëm me miratimin e ERE-s.

Neni 12

Çmimi

Çmimet i shitjes së energjisë elektrike së kësaj kontrate është ai i përcaktuar me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë KESH sh.a. nr. _____, datë _____ dhe ky çmim i shitjes do të jetë 1.5 lekë/kwh.

Neni 13

Kufizimi i përgjegjësisë financiare

1. Përjashtimi i përgjegjësisë financiare: subjekt i pikave 13.2 dhe 13.3 dhe përveç kur lidhet me shumat e pagueshme sipas nenit 9 (Zhdëmtimet), një Palë dhe punonjësit e saj, zyrtarët, kontraktorët dhe/ose agentët, nuk kanë përgjegjësi financiare ndaj Palës tjetër për asnjë humbje, kosto, shpenzim ose dëm ("Dëmet"), (përfshirë, pa kufizim, çdo përgjegjësi financiare për shkak të çrregullimeve në furnizimin me energji elektrike sipas një kontrate individuale) që pëson Pala tjetër sipas Marrëveshjes ose lidhur me të, përveç kur këto dëme shkaktohen nga neglizhenca e madhe, mospagesa e qëllimshme ose mashtrimi i një Pale ose punonjësve, zyrtarëve, kontraktorëve dhe/ose agentëve të saj, përdorur nga kjo Palë për kryerjen e detyrimeve të saj sipas kontratës.

2. Dëmi pasues dhe kufizimi i përgjegjësisë financiare: subjekt i pikës 13.3, përgjegjësia ligjore e një Pale sipas kontratës ose lidhur me të:

a) Nuk përfshin përgjegjësinë financiare për dëme indirekte dhe/ose pasuese, përfshirë, pa u kufizuar, humbjen e fitimit, klientelës, mundësive për biznes ose kursimeve të parashikuara; dhe

b) Kufizohet me një shumë të barabartë me shumat e pagueshme për energjinë elektrike të furnizuar ose që do të furnizohet nga një Palë sipas çdo kontrate individuale përkatëse me kusht që ky kufizim të moszbatohet për pagesat sipas pikës 9 (*Zhdëmtimet për paaftësinë për livrim dhe pranim*).



3. Mospagesa e qëllimshme, mashtrimi dhe të drejtat themelore: asgjë në Marrëveshje nuk vepron për të përjashtuar ose kufizuar përgjegjësinë ligjore të Palës, për:

a) Mospagesën e qëllimshme,

b) Mashtrimin; ose

c) Çdo veprim që rrezikon të drejtat ligjore themelore të një Pale ose që shkel detyrimet kontraktuale themelore të një Pale.

4. Detyra për lehtësimin e humbjeve: për shmangien e dyshimit dhe subjekt i legjislacionit në fuqi, çdo Palë bie dakord se ka për detyrë të lehtësojë dëmet dhe premtion që do të përdorë përpjekje komercialisht të arsyeshme për minimizimin e çdo dëmi që mund të pësojë sipas kontratës ose lidhur me të.

Neni 14

Faturimi dhe pagesa

1. Blerësi, brenda datës 5 të muajit pasardhës, të livrimit të energjisë elektrike, duhet t'i dërgojë Shitësit informacion mbi sasinë faktike të energjisë elektrike shitur klientëve fundorë që përfitojnë nga Furnizimi i Shërbimit Universal, me qëllim sistemimin e veprimeve sipas nenit 9 të kësaj kontrate.

2. Shitësi do t'i dorëzojë Blerësit një faturë sipas formatit dhe standardeve që parashikon legjislacioni në fuqi, e cila paraqet sasinë totale të energjisë elektrike të livruar nga Shitësi dhe konsumuar nga Blerësi për muajin kalendarik paraardhës. Paraqitja e kësaj fature do të bëhet brenda datës 10 të muajit pasardhës të livrimit të energjisë elektrike (ose kur kjo datë është pushim zyrtar, ditën pasardhëse të punës). Krahas faturës, Shitësi do t'i dorëzojë Blerësit edhe aktrakordin përkatës. Nëse Blerësi nuk dorëzon brenda afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, informacion mbi sasinë faktike të energjisë elektrike shitur klientëve fundorë, atëherë Shitësi do të lëshojë faturën çdo datë 10 të muajit respektiv, bazuar në sasinë totale të programuara/konfirmuara.

3. Pagesa; Blerësi do t'i kryejë pagesën Shitësit kundrejt vlerës së faturës mujore. Pagesa do të bëhet brenda 30 ditëve nga dita e njoftimit të faturës nga Shitësi. Data e pagesës do të konsiderohet data që nga llogaria e Blerësit preken fondet monetare.

4. Vonesa në kryerjen e pagesës; Nëse Blerësi dështon në kryerjen e pagesës brenda afatit të përcaktuar në këtë kontratë, shpërblimi për dëmet e shkaktuara si rezultat i vonesës, do të jetë sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

5. Shumat e diskutueshme; për çdo pretendim që lidhet me saktësinë e faturës, do të jepet një shpjegim me shkrim nga Shitësi ose Blerësi dhe korrektimet në faturë do të bëhen vetëm brenda muajit të faturuar, në të kundërt do të paguhet shuma e faturuar jo më vonë se data e afatit të pagesës dhe diferencat (shtesat apo pakësimet) nga korrektimet do të reflektohen në muajt pasardhës.

6. Kur dhe nëse të dhënat janë të disponueshme, e konfirmojnë se sasia e energjisë së livruar dhe të marrë, ndryshon nga sasia e energjisë së programuar për livrim, faturimet do të axhustohen brenda muajit respektiv për të reflektuar ndryshimet e devijimet midis programit dhe sasisë aktuale të livruar.

Neni 15

TVSH-ja dhe taksat

1. TVSH-ja: të gjitha shumat e referuara në këtë kontratë përjashtojnë çdo vlerë të zbatueshme të taksës së shtuar ("TVSH"). Nëse TVSH-ja është e pagueshme për çdo shumë të tillë, Blerësi do t'i paguajë Shitësit një shumë të barabartë me TVSH-në me tarifën e zbatueshme. Një shumë e barabartë me TVSH-në e pagueshme nga një Palë do të kërkohej për t'u paguar vetëm kur Pala tjetër të sigurojë një faturë të vlefshme TVSH-je lidhur me atë shumë. Çdo Palë, për aq sa e lejon ligji, do t'i sigurojë palës tjetër fatura TVSH-je shtesë të vlefshme që kërkohej për qëllimet e kontratës.

2. Detyrimet e taksave të Shitësit dhe Blerësit: Shitësi do të paguajë ose shkaktojë pagesën e gjithë taksave për sasinë e kontratës ose lidhur me të që del para transferimit të riskut dhe titullit në Pikën e Livrimit. Blerësi do të paguajë ose do të shkaktojë pagesën e gjithë taksave në sasinë e kontratës ose lidhur me të ose të kontratës individuale që dalin gjatë ose pas transferimit të riskut dhe titullit në Pikën e Livrimit (përveç taksës direkte ose indirekte që lidhet me shitjen e sasisë së kontratës dhe është përgjegjësi ligjore e Shitësit). Në rast se Shitësit i kërkohej me ligj të paguajë çdo taksë të përshtatshme për llogarinë e



Blerësit, Blerësi do ta zhdëmtojë ose rimbursojë menjëherë Shitësin për këtë taksë. Në rast se Blerësit i kërkohet me ligj të paguajë çdo Taksë të përshtatshme për llogarinë e Shitësit, Blerësi mund ta zbresë shumën e kësaj takse nga shumat e detyrueshme Shitësit sipas kontratës dhe Shitësi do ta zhdëmtojë ose rimbursojë menjëherë Blerësin lidhur me këto taksa të pazbritura. Nëse ndonjë taksë e re bëhet e zbatueshme ose një taksë ekzistuese rritet lidhur me kontratën dhe Blerësi është në gjendje ta kalojë përmes një pale të tretë, Blerësi do të jetë përgjegjës për këtë taksë të re ose të rritur.

3. Taksa e mbajtur: pagesat lirë dhe qartë. Gjithë pagesat sipas një kontrate individuale do të bëhen pa mbajtje ose zbritje për llogari të çdo takse përveç kur kjo mbajtje ose zbritje kërkohet me ligj. Nëse një Pale i kërkohet të mbajë ose zbresë taksën nga një pagesë që duhet të bëjë, atëherë ajo Palë (“Pala Pagueuse”) do të njoftojë menjëherë Palën tjetër (“Pala Marrëse”) për këtë kërkesë dhe do t’u paguajë autoriteteve të duhura gjithë shumat e mbajtura ose të zbritura prej saj. Nëse mund të lëshohet një faturë ose provë tjetër që evidenton pagesën tek autoritetet, Pala Pagueuse do t’ia dorëzojë këtë provë (ose një kopje të certifikuar) Palës Marrëse.

4. Minimizimi i taksave: të dyja Palët do të përdorin përpjekje të arsyeshme për të administruar kontratën dhe për të zbatuar dispozitat e saj sipas synimit për minimizimin e akumulimit të detyrimeve për pagesën e taksës, kur është e arsyeshme dhe e mundur.

Neni 16

Sigurimi i pasqyrave financiare dhe vlera neto e prekshme

1. Sigurimi i pasqyrave financiare: përveç kur specifikohet ndryshe, nëse kërkohet nga njëra palë. Pala tjetër do t’i dorëzojë asaj:

a) Brenda 180 ditëve pas mbarimit të çdo viti fiskal, një kopje të raportit vjetor që përmban pasqyra financiare të audituara dhe të konsoliduara për këtë vit fiskal, për periudhën kur detyrimi i Palës tjetër mbështetet nga garantuesi i kredisë ose nëse është palë e një marrëveshje kontrolli dhe transferimi të fitimit, nga garantuesi i kredisë ose Pala Kontrolluese, sipas rastit; dhe

b) Brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve pas përfundimit të secilit nga tre tremujorët e tij fiskalë të çdo viti fiskal, një kopje të raportit tremujor që përmban pasqyra financiare të paaudituar të konsoliduar.

2. Rënia e vlerës neto të prekshme: sapo të bëhet e ndërgjegjshme për këtë rënie, çdo Palë do të njoftojë menjëherë Palën tjetër për ndodhinë e rënies së vlerës neto të prekshme ose vlerës neto të prekshme të garantuesit të kredisë ose Palës Kontrolluese, në një nivel nën shumën e specifikuar nga Palët.

3. Parimet financiare: në çdo rast deklaratat financiare që referohen në pikën 17 do të përgatiten sipas parimeve financiare në Republikën e Shqipërisë.

Neni 17

Transferimi

1. Ndalimi: asnjëra Palë nuk do të autorizohet që t’ia transferojë të drejtat dhe detyrimet e veta sipas kontratës, një pale të tretë pa pëlqimin paraprak me shkrim të Palës tjetër, i cili nuk do të vonohet, refuzohet ose pengohet në mënyrë të paarsyeshme dhe me miratimin e ERE-s.

2. Transferimi të filialet: çdo Palë do të autorizohet t’ia transferojë të drejtat dhe detyrimet e veta sipas kontratës, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Palës tjetër, një filiali me aftësi pagueuse të njëjtë ose më të madhe. Ky transferim do të hyjë në fuqi vetëm pas marrjes së njoftimit nga Pala tjetër dhe, me kusht që çdo dokument mbështetës kredie i nxjerrë ose i vendosur në emër të Palës transferuese të jetë rinxjerrë ose amenduar fillimisht për të mbështetur detyrimet e filiait në përfitim të Palës tjetër.

Neni 18

Përfaqësimet dhe garancitë

1. Nëse specifikohet si e zbatueshme për Palët, ajo Palë përfaqëson dhe garanton në këtë mënyrë Palën tjetër pas hyrjes në këtë kontratë për sa vijon:

a) Se është një njësi e organizuar si duhet, që ekziston në mënyrë të arsyeshme dhe sipas ligjeve të juridiksionit të korporatës ose organizatës;

